



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 16.07.2013
Nr. 0204-922

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS,
01NR.353-105854 të Pranuar me datë, 10.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 nr. 353-105854 të miratuar me datën 28.06.2013 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Akti juridik i listuar si vijon, ka efekt të plotë juridik.

- Vendim 01nr.353-105854 për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës Gjermane.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 16.07.2013
Br. 0204-922

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik Opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine Opštine Priština

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE PRIŠTINA,
01BR.353-105854 primljeno dana, 10.07.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim prema članu 82 Zakonu br. 03-L-040 za lokalnu samoupravu, dodatak XII Uredbe Vlade Nr.02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke 01br.353-105854 usvojene dana 04.07.2013 od Skupštine Opštine Priština, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu i Zakonu Br.04/L-144 za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine .

Pravni akt niže navaden ima puni pravni efekat.

- Odluka 01br. 353-105854 za nastavak davanja na korišćenje nepokretne imovine Nemačkoj Ambasadi.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera & Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, pragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit nr. 04/L -144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.06.2013, miratoi këtë

V E N D I M
PËR VAZHDIMIN E DHËNIES SË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AMBASADËS GJERMANE

I.

Miratohet Vendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ambasadës gjermane, sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 01. nr. 353 - 854, të dt. 12.5.2009 dhe Kontratës për shfrytëzimin e përkohshëm të parcelave kadastrale nga Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë, 01. nr. 353 - 854/1 të dt. 02.07.2009.

II.

Sipas pikës I të këtij vendimi, vazhdimi i dhënies në shfrytëzim bëhet për pjesën e parcelës kadastrale nr. 2987/1, në sipërfaqe prej 1 306 m², dhe pjesën e parcelës kadastrale nr. 7708, në sipërfaqe prej 119 m².

III.

E drejta e shfrytëzimit të tokës të përshkruar në pikën I të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim, në kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

IV.

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të tokës, sipas këtij vendimi, do të caktohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

V.

Në tokën e dhënë në shfrytëzim nuk mund të bëhen intervenime ndërtimore, dhe as ndryshime në infrastrukturë dhe në ambientin përreth, të cilat do të ndikonin në destinimin parësor të tij, pa lejen përkatëse të Drejtorisë së Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

VI.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe e Pronës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, të cilat do t'i kryejnë veprimet e nevojshme për realizimin e këtij vendimi.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr.353-105854, më 02.07.2013

